



TREGUESIT STATISTIKOR TË SHËRBIMEVE POSTARE

Tremujori I 2023

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

Përmbajtje

I. HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE.....	5
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare.....	5
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare	8
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar	7
4. Treguesit e shërbimit ekspres	8

I. HYRJJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesorë të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesorë të tregut postar për tremujorin e parë të vitit 2023, si edhe krahasimet me tremujorin e katërt të vitit 2022 dhe me tremujorin e parë të vitit 2022, i cili publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al, në seksionin “Statistika rreth AKEP” - “Shërbimet Postare”.

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e parë të vitit 2023 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP për periudhën e raportimit janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (35 subjekte):**
 1. Albanian Cargo Service sh.p.k. (A.C.S.)
 2. Albanian Delivery Express sh.p.k.
 3. ALBANIAN PARCEL DISTRIBUTION shpk
 4. Alfa Courier Services shp.k.
 5. ALOPOST sh.p.k.
 6. Balkan Courier & Logistics sh.p.k.
 7. BIPEX sh.p.k.
 8. Blendi Dokollari –Person Fizik (Flash Delivery Albania)
 9. COURIER GROUP sh.p.k.
 10. DANDEX COURIER EXPRESS sh.p.k
 11. DHL International (Albania) sh.p.k.
 12. EXPRESS ALB 24 sh.p.k.
 13. Fast Express Post sh.p.k.
 14. Fenix Post & Delivery Albania sh.p.k.
 15. GED sh.p.k. (ish B.E.D. sh.p.k.)
 16. GENIKI TAXYDROMIKI ALB sh.p.k
 17. Greenposta shpk

18. I V Y sh.p.k.
19. IDEX IdealExpress sh.p.k. (ish All In One Cool sh.p.k.)
20. INTEX COURIER sh.p.k.
21. IPOST sh.p.k.
22. Milsped Albania sh.p.k.
23. Mr. COURIER sh.p.k.
24. Ndriçim Osmani (Person fizik)
25. POSTA JONË sh.p.k.
26. POSTMAN sh.p.k.
27. T.N.T Express Albania sh.p.k.
28. Top Post sh.p.k.
29. TURBOO ALBANIA sh.p.k.
30. Ultra C.E.P. sh.p.k.
31. Ulysses Enterprises sh.p.k.(Fedex)
32. United Transport sh.p.k. (Uni Trans)
33. Youth Albania Professional Services (YAPS)

Gjatë periudhës, nga tremujori i katërt i vitit 2022 deri në tremujorin e parë të vitit 2023, ka 1 subjekt të çregjistruar për ofrimin e shërbimeve postare dhe kanë raportuar të dhënat statistikore 26 subjekte¹.

Posta Shqiptare me VKD Nr.13, datë 30.06.2020 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

¹ Ofrues të shërbimeve postare që kanë raportuar të dhënat statistikore në AKEP deri më datë 20.04.2023

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara nga ofruesit e shërbimeve postare përbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare;
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres.

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 rezultojnë 6,732,726 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të dhëna në mënyrë më të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela 1.1: Të dhëna përmbledhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara

Shërbime postare të ofruara		T1_2022	T2_2022	T3_2022	T4_2022	T1_2023	Ndryshim T1_2023/ T4_2022	Ndryshim T1_2023/ T1_2022
Posta Shqiptare sh.a								
1	Shërbim Universal Postar							
1.1	Postë brenda vendit	5,087,129	5,234,188	5,001,676	5,906,952	5,351,099	-9%	5%
1.2	Postë ndërkombëtare	158,687	162,271	222,394	186,079	184,390	-1%	16%
1.3	Totali 1.1+1.2	5,245,816	5,396,459	5,224,070	6,093,031	5,535,489	-9%	6%
2	Shërbim jouniversal postar							
2.1	Postë brenda vendit	80,114	118,161	106,925	101,500	92,252	-9%	15%
2.2	Postë ndërkombëtare	381	403	431	449	146	-67%	-62%
2.3	Totali 2.1+2.2	80,495	118,564	107,356	101,949	92,398	-9%	15%
3	Shërbim ekspres							
3.1	Ekspres brenda vendit	156,598	140,469	119,412	124,731	126,129	1%	-19%
3.2	Ekspres ndërkombëtar	4,992	2,435	4,340	3,411	3,883	14%	-22%
3.3	Totali 3.1+3.2	161,590	142,904	123,752	128,142	130,012	1%	-20%
Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare								
4	Shërbim JoUniversal Postar							
4.1	Postë brenda vendit	331,957	558,871	554,520	205,826	196,289	-5%	-41%
4.2	Postë ndërkombëtare	16,286	14,456	9,575	4,429	2,819	-36%	-83%
4.3	Totali 4.1+4.2	348,243	573,327	564,095	210,255	199,108	-5%	-43%
5	Shërbim ekspres							
5.1	Ekspres brenda vendit	670,509	962,927	1,200,322	779,474	712,332	-9%	6%
5.2	Ekspres ndërkombëtar	58,354	54,322	58,120	93,927	63,387	-33%	9%
5.3	Totali 5.1+5.2	728,863	1,017,249	1,258,442	873,401	775,719	-11%	6%
6	Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	6,565,007	7,248,503	7,277,715	7,406,778	6,732,726	-9%	3%

Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Në mënyrë të përmbledhur në vijim paraqiten disa nga zhvillimet kryesore në këtë treg:

Posta Shqiptare (Ofrues i Shërbimit Universal)

- ✓ **Shërbim universal postar.** Ky zë në total ka pësuar rritje nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës në masën 6%, ndërsa nëse e krahasojmë me 3 mujorin e mëparshëm ka pasur një rënie në masën 9%. Zëri **Postë brenda vendit** ka pasur një rritje në masën 5% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm dhe një rënie prej 9% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm, dhe zëri **Postë Ndërkombëtare** ka një rritje nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të një viti më parë në nivelin 16% dhe një rënie nëse e krahasojmë me 3-mujorin e mëparshëm në masën 1%.
- ✓ **Shërbimi Jo universal postar.** Ky zë në total ka pësuar një rritje në nivelin 15% nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe një rënie në masën 9% nëse e krahasojmë me 3-mujorin e mëparshëm. Pak a shumë në të njëjtat nivele është dhe **Postë brenda vendit** ndërkohë që **Postë ndërkombëtare** ka një rënie me 62% nëse e krahasojmë me vitin e kaluar dhe rënie me 67% nëse e krahasojmë me 3-mujorin e mëparshëm.
- ✓ **Shërbimi Ekspres** Ky zë në total ka pësuar rënie nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 20% dhe rritje në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm në masën 1%. Në të njëjtat nivele është afërsisht dhe volumi i shërbimit **Ekspres brenda vendit** me një rënie në masën 19% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe një rritje prej 1% në krahasim me 3 mujorin e mëparshëm, ndërkohë që **Ekspres Ndërkombëtar** ka pësuar rënie si krahasuar me vitin e kaluar në masën 22%, dhe një rritje në masën 14% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm.

Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare


- ✓ **Shërbimi Jo Universal Postar.** Ky zë ka një rënie në 3-mujorin e I 2023 në krahasim me 3-mujorin e IV të 2022 në masën 5% ndërkohë që në krahasim me 3-mujorin I të vitit të kaluar kemi një rënie të ndjeshme prej 43%. Ndërsa zëri **Postë brenda vendit** është në po këto nivele kurse **Postë ndërkombëtare** ka një rënie prej 36% në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm dhe një rënie të konsiderueshme prej 83% në krahasim me 3-mujorin I të vitit të kaluar.
- ✓ **Shërbimi ekspres.** Ky zë ka rënie në totalin e tij krahasuar me 3-mujorin e kaluar në masën 11%, por ka pësuar rritje në masen 6% krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë që zëri i shërbimit **Ekspres brenda vendit** ka një rënie prej 9% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm dhe një rritje në masën 6% krahasuar me vitin e kaluar.

Tabela 1.2: Totali i objekteve postare-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T1 2023

	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	5,757,899	86%
<i>Of. e tjerë</i>	974,827	14%
Totali	6,732,726	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafiku 1.1: Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, shikojmë një rënie në objektet postare në T1_2023 krahasuar me T4_2022 si për Postën Shqiptare ashtu edhe për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë kemi një rritje të totalit të objekteve postare për Postën Shqiptare, ndërsa për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë shënuar rënie krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë.


Tabela 1.3: Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T1_2023

Sh. U	Sh. jo univers.	Sh. ekspres	Totali
5,535,489	291,506	905,731	6,732,726
82%	4%	13%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me 82%, ndjekur nga shërbimi ekspres me 13% dhe shërbimi jo universal 5 %.

Grafiku 1.2: Ecuria në 3-mujor sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar. Nga krahasimi i periudhës T1_2023 me periudhën T4_2022 vërehet që kemi një rënie në masën 9% në volumin total të shërbimeve postare, ndërsa duke e krahasuar me të njëjtën periudhë, një vit më parë kemi një rritje në masën 3%.

2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare


Tabela 1.4: Shërbimi Universal Postar T1_2023

Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	5,351,099
Postë ndërkombëtare	184,390
Totali	6,093,031

Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga të dhënat e tabelës 1.4 për T1_2023, për sa i përket shërbimit Universal Postar, vihet re se Posta Shqiptare realizoi gjithsej 5,535,489 objekte, nga të cilat posta brenda vendit zë 97% të objekteve postare dhe posta ndërkombëtare zë 3% të objekteve postare. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 4,565,283 shërbime për objekte të thjeshta dhe 785,816 shërbime për objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 37,305 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 147,085 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

Grafiku 1.3: Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 muajor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga grafiku i mësipërm, shikohet një rënie e shërbimit universal postar në T1_2023 krahasuar me T4_2022, me 9%.

3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare

Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:


Tabela 1.5: Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Sh

Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesa tregut T_1 2023	Pjesa tregut T_1 2022
Shërbim universal postar	5,535,489	96.1%	95.6%
Shërbim jo universal postar	92,398	1.6%	1.5%
Shërbim ekspres	130,012	2.3%	2.9%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare, që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 96.1%, i ndjekur nga shërbimi ekspres me 2.3% dhe nga shërbimi jo universal postar 1.6%. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi një rritje të vogël Shërbimit jo universal postar dhe rënie të Shërbimit ekspres.

Grafiku 1.4: Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare, ku vihet re një rënie e shërbimit universal dhe jo universal dhe rritje për shërbimin ekspres në T1_2023 krahasuar me T4_2022.

4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

Tabela 1.6: Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T1_2023	Pjesë tregu T1_2022
P.Sh	92,398	32%	19%
Of. e tjerë	199,108	68%	81%
Totali	291,506	100%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafiku 1.5: Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në T1_2023 krahasuar me T4_2022 kanë pësuar rënie në total në masën 21% ku për Postën Shqiptare rënia është 9% ndërsa për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare rënia është 26%

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare gjatë T1 2023 përbëhet nga 288,541 objekte brenda vendit dhe 2,965 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.

5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të parë të vitit 2023, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2022, mbi baza tremujore.

Tabela 1.7: Shërbimi ekspres-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për T1_2023

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T1_2023	Pjesë tregu T1_2022
P. Shqiptare	130,012	14%	18%
Of. e tjerë	775,719	86%	82%
Totali	905,731	100%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafik 1.6: Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Shërbimi ekspres, gjatë T1_2023 ka pësuar rënie në krahasim me T4_2022 në masën 11% dhe në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar rënie në masën 5%. Duhet theksuar se ndikimin më të madh në këtë rënie e kanë Ofruesit e tjerë.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë së bashku është në vlerën 838,461 objekte postare ose 93% e totalit të këtij shërbimi, ndërsa shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 67,270 objekte postare ose 7% e totalit të këtij shërbimi për periudhën raportuese.

Për sa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri është në vlerën 42,883 objekte dhe sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit është në vlerën 24,387 objekte.